



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.16, datë 02. 05. 2012

**PËR**

**“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.25, DATË 28.12.2011, PËR “MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2012”, ME QËLLIM SHPËRBLIMIN E SPORTISTES ROMELA BEGAJ NGA KLUBI SPORTIV “TIRANA”, PËR ARRITJE TË REZULTATEVE TË LARTA SPORTIVE”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 10 pikat 1 dhe 3/II, nenit 32 shkronja “dh” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe Funkcionimin e Qeverisjes Vendore” (i ndryshuar); nenit 26 të ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 për “Sportin”, (i ndryshuar); vendimit nr. 1720, datë 29.10.2008 të Këshillit të Ministrave për “Kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportive, për mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që i arrijnë këto nivele, si dhe për përfitimin e trajtimit për përgatitjen sportive”, (i ndryshuar); vendimit nr. 25, datë 28.12.2011 për “Miratimin e Buxhetit të vitit 2012”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë një shtesë në buxhetin e Klubit Sportiv “Tirana” për shpërblimin e sportistes Romela Begaj për arritje të rezultateve të larta sportive, shpalljen Nënkampione e Europës në peshëngritje, në strukturën dhe artikullin si më poshtë:

**Gr.00. Tit. 08140. Artikulli 606      2 000 000 (dy milionë lekë)**

2. Efektet financiare të pikës 1 të vendimit, të përballohen duke pakësuar Fondin Rezervë të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012, në të njëjtën shumë.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Klubi Sportiv “Tirana”, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**Niazi KOSOVRASTI**